



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR “DR.STEFAN GJONI”
KRUJE

Rruga Nene Tereza, Lagjia nr 1, Kruje, Albania TEL: +355 511 2 2006

spitalikruje@shendetesia.gov.al

Kruje me 14.04.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“ Blerje Kite dhe reagente laboratorike per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Dr. Stefan Gjoni ” Kruje ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (33696500-0;33696100-6,33696000-5)

“Blerje Kite dhe reagente laboratorike” procedure e hapur e thjeshtuar Marreveshje kuader 24 mujore

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 824 063 (shtate miljon e teteqind e njezet e kater mije e gjashtedhete e tre) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Nuk është i aplikueshem)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

221 a) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2019,2020,2021**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë.

ose

b) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet e tre viteve të fundit (2019-2020-2021) të çertifikuara nga organet tatimore, si dhe raportet e ekspertit kontabel për këto vite.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjerat tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti teknik:

221. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate qe 3 129 625.2 (tre milion e njeqind e njezet e nente mije e gjashtëqind e njezet e pese.dy) leke pa t.v.sh (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.Operatori ekonomik duhet të deklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese.

Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese ose vetëdeklarim i distributorit të autorizuar) per secilin artikull per respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara nga shërbimi mjekesor.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qellim njohjen e origjines se mallit dhe kompanin prodhuese per identifikimin ne menyre te qarte gjate levrimit te tij dhe per te pasur siguri qe i njeiti mall i ofruar do te levrohet ne destinacion ne perputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 te vkm 285 date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Keto kerkesa i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise per njohjen e mundesise se operatorik ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi.

3. Certifikate konformiteti CE per materialet mjekesore te prodhuesit per mallrat e ofruar. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave. Kjo pike

mund te plotesohet edhe nepermjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratë konformiteti (DC), nga operatori ekonomik.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

4. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull.Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

5.Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit.

6.Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .

7.Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 per distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore dhe reagenteve laboratorike. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilesise se mallrave objekt prokurimi.

8.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

- Gjate dorezimit te mallit ne depot e bleresit , kitet e reagentet te shoqerohen me raport analizi dhe certefikate origjine .

- Kitet dhe reagentet te kene te shenuar mbishkrimin CE dhe shtetin ku jane prodhuar .Sasite e kiteve dhe reagenteve dhe cilesite te jene sipas kerkeses se dhene ne dokumentat e

tenderit , ndersa per paketim pranohet dhe I ndryshem , mjafton sasia .

- Kitet dhe reagentet duhet te kene te shenuar saktesisht shoqerine prodhuese dhe shtetin e origjines .
- Kitet dhe reagentet daten e skadences duhet ta kene te shenuar ne amballazh (kutite) e cila ne momentin e levrimit duhet te jete jo me pak se nje vit ,perjashtim bejne kitet kontroll me skadence 6 muaj + .
- Amballazhimi te jete I pershtatshem sipas llojit te mallit te shoqeruar me etiketat perkatese .
- Kitet dhe reagentet duhet te jene ne perputhje me pershkrimet ne emertimet e dhena ne DST .
- Kitet dhe reagentet e kerkuara per aparaturat duhet te jene te pershtatshme edhe per aparatura analizator ichroma reader , koagulometer gjysme automatik , analizatorine gjakut Abacus 3CT , dhe Autoanalizator Biokimik Selectra Pro XS ose ekuivalentet e kompatibel me aparaturat e siperpermendura qe disponon institucioni.
- Kerkohet qe kitet dhe reagentet te jene te pershtatshem per instrumentat ose ekuivalent ekomatibel me aparaturat e siperpermendura qe disponon institucioni. Kitet dhe reagentet daten e skadences duhet ta kene te shenuar ne amballazh e cila ne momentin e levrimit duhet te jete jo me pak se nje vit., perjashtim bejne kitet me kontroll 6 muaj +.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK: